

THIRRJE PËR PROPOZIME**KËRKESË PËR PROPOZIM (KPP)**

[Emri i organizatës]

I nderuar/e nderuar zotëri/zonjë,

Projekti:

Numri i projektit:

1. Ju lutemi që ofertën për shërbimet e mëposhtme ta dërgoni në përputhje me udhëzimet e bashkëngjitura për ofertuesit. Propozimi mund të dërgohet në datën ose para datës së përcaktuar në udhëzimet për furnitorë dhe do të mbetet i hapur në rast të shtyrjes së afatit të lartëcekur kohor për dërgimin e propozimit.

2. Detajet e termave të referencave mund të gjenden në Shtojcën 1 të kësaj KPP-je. Gjatë përgatitjes së propozimit tuaj, ju lutemi që t'i ndiqni udhëzimet e bashkëngjitura në Shtojcën 2 dhe në shtojcat tjera.

3. Të dhënat e kërkesës për propozim:

Titulli i kontratës:	
Data e publikimit:	
Numri i referencës:	
Afati i fundit kohor:	
Autoriteti kontraktues:	
Adresa:	
E-maili për dërgimin e propozimeve:	

Është përgjegjësia juaj që të siguroheni se propozimi juaj do të arrijë në adresën e mësipërme në afatin e fundit kohor ose para kësaj date. Propozimet të cilat për cilëndo arsye pranohen pas afatit të përcaktuar më lart, nuk do të merren parasysh për vlerësim.

Bashkëngjitur gjenden dokumentet e mëposhtme të cilat përbëjnë dosjen:

- A. Udhëzimet për ofertuesit
- B. Specifikacionet teknike + oferta teknike
- C. Formulari për aplikim

- D. Deklarata nga ofertuesit
- E. Draft-kontrata

Udhëzimet dhe informatat për ofertuesit

Ky kapitull ofron udhëzime të hollësishme që duhen të ndiqen për t'iu përgjigjur kësaj KPP-je.

Dërgimi i ofertave

Ofertuesit duhet t'i dërgojnë të gjithë propozimet përmes kopjes elektronike/kopjes së printuar në [shëno adresen elektronike], jo më vonë se data data/muaji/viti në ora [p.sh. 13:00], me titullin "KPP#". Të gjitha dokumentet e dërguara duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara për propozim. Të gjitha propozimet duhet të plotësohen në shtojcën në vijim të kësaj Kërkese për Propozim.

Pyetjet: Pyetjet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike të kësaj Kërkese për Propozim mund të dërgohen vetëm në mënyrë elektronike në [shëno adresen elektronike], jo më vonë se 3 ditë para afatit të fundit kohor për dorëzim. Çfarëdo informacioni verbal i pranuar nga punonjësit e organizatës ose ndonjë subjekt tjetër nuk do të konsiderohet si përgjigje formale për cilëndo pyetje në lidhje me këtë Kërkesë.

Termet dhe kushtet

1. Autoriteti kontraktues mban të drejtën që t'i ndryshojë dispozitat e kësaj KPP-je në çdo kohë, para datës së caktuar për përgjigjet me shkrim. Mund të shtohen kushte dhe kërkesa të tjera. Njoftimi për ndryshimet e tilla do t'u ofrohet të gjithë ofertuesve.
2. Propozimet duhet të dërgohen në përputhje me këto udhëzime dhe dokumentet tjera në Kërkesën për Propozim (së bashku me të gjitha informatat përkatëse që kërkohen për të përshkruar propozimin në tërësi), jo më vonë se koha dhe data e caktuar në thirrjen për propozim.
3. Ofertuesit duhet të kontrollojnë nëse të gjitha dokumentet e paraqitura në Kërkesën për Propozim janë pranuar dhe kompletuar në të gjitha aspektet. Nuk do të merret parasysh asnjë kërkesë që shtrohet si rezultat i dështimit për të mësuar rreth detajeve të përfshira në këtë dokument ose për të siguruar një informacion të tillë.
4. Ofertuesit duhet t'i marrin përsipër të gjitha kostot dhe shpenzimet e tyre të shfaqura gjatë përgatitjes dhe dërgimit të propozimit.
5. Të gjitha komunikimet në lidhje me këtë kërkesë për propozim duhet të jenë në mënyrë ekskluzive vetëm me nënshkruesin e thirrjes për propozim. Ofertuesit paralajmërohen se çfarëdo

komunikimi tjetër, qoftë me shkrim apo formë tjetër, nuk do të jetë pjesë e ndonjë kontrate dhe mund të rezultojë me diskualifikim të ofertës suaj.

6. Çfarëdo mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total (që fitohet përmes shumëzimit të çmimit për njësi dhe sasisë) do të llogaritet përsëri nga autoriteti kontraktues. Do të mbizotërojë çmimi për njësi, teksa do të korrigjohet çmimi i përgjithshëm. Nëse furnitori nuk e pranon çmimin përfundimtar bazuar në rillogaritjen dhe korrigjimin e gabimeve nga ana e autoritetit kontraktues, oferta e tij/saj do të refuzohet.

7. Autoriteti kontraktues mban të drejtën që të refuzojë cilindo propozim apo të gjitha propozimet e pranuar ose të kërkojë shpjegime të mëtejshme nga ofertuesit.

8. Para dhënies së kontratës, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë ose të kërkojë nga ta një intervistë të shpejtë për të ndihmuar në procesin e vlerësimit.

Informatat që duhet të dërgohen nga ofertuesi:

Së bashku me ofertën, kompania duhet t'i bashkëngjës këto dokumente:

- Formulari për propozim dhe formulari për financim,
- Vërtetimi mbi konfliktin e interesit,
- Certifikata e regjistrimit,
- Certifikata e numrit fiskal, dhe
- Profili i kompanisë, CV-të dhe referencat.

Vlerësimi i propozimeve / kriteret për dhënien e kontratës

Përderisa çmimi është një faktor i rëndësishëm, autoriteti kontraktues do t'i vlerësojë propozimet rreth çmimeve si dhe kriteret në vijim:

Kriteri 1	Cilësia e përgjithshme dhe niveli i profesionalizmit:	Vlerësimi	20%
Kriteri 2	Të kuptuarit e projektit dhe metodologjia:	Vlerësimi	15%
Kriteri 3	Përmbushja e kërkesave:	Vlerësimi	15%
Kriteri 4	Përvoja relevante dhe portofoli:	Vlerësimi	10%
Kriteri 5	Kapaciteti i shërbimit:	Vlerësimi	20%
Kriteri 6	Çmimi më i ulët:	Vlerësimi	30%

Shtojca 1.

SPECIFIKACIONET TEKNIKE + OFERTA TEKNIKE

- I. Historiku
- II. Fushëveprimi dhe metodologjia
- III. Specifikacionet e kërkuara
- IV. Kohëzgjatja dhe korniza kohore
- V. Kërkesat për kualifikim

Shtojca 2.

FORMULARI PËR DORËZIMIN E OFERTËS – PROPOZIMI TEKNIK

Për ta thjeshtëzuar procesin e vlerësimit dhe për të siguruar krahasueshmëri maksimale, autoriteti kontraktues kërkon që të gjitha përgjigjet në KPP të jenë të organizuara në mënyrën dhe formatin e paraqitur më poshtë.

1. DORËZUAR nga (dmth. identiteti i ofertuesit)

	Emri(at) and adresa(at) e subjektit ligjor ose subjekteve që e dorëzojnë këtë ofertë
Drejtori	
Numri i regjistrimit / Numri unik	

2. PERSONI KONTAKTUES (për këtë KPP)

Emri:	
Pozita:	
Adresa:	
Telefoni:	
E-maili	

- A. Qasja ndaj shërbimeve dhe korniza kohore
- B. Metodologjia, planifikimi dhe mjetet për ofrimin e shërbimeve të kërkuara
- C. Sistemi i kontrollit të cilësisë për të garantuar cilësi të shërbimeve dhe respektuar afatet kohore
- C. Kualifikimet e ekipit

Emri dhe mbiemri:	Pozita:	Përvoja ndër vite:	Profesioni:	Përgjegjësitë për këtë ofertë:	Biografia e shkurtër:

Bashkëngjiteni CV-në.

- D. Fushat e specializimit dhe përvoja

Nr. i referencave (maksimum 5)	Lloji i shërbimit			
Emri i klientit ose subjektit	Shteti	Datat (fillimi/përfundimi)	Lloji dhe fushëveprimi i shërbimeve të ofruara	Numri i personelit të angazhuar

Shtojca 3.

FORMA E BUXHETIT – PROPOZIMI FINANCIAR

Emri i ofertuesit:		Valuta:	
Titulli i referencës së KPP-së:			

Nr.	Përshkrimi	Korniza kohore	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
				Gjithsej	

Shtojca 4.

DEKLARATA NGA OFERTUESI:

Përmes dorëzimit të ofertës, zotoheni se jeni duke e kuptuar kërkesën dhe i keni trajtuar mjaftueshëm të gjitha aspektet e KPP-së dhe informacionin që gjendet në kuadër të hapësirës së të dhënave dhe se i keni kontrolluar të gjitha detajet e nënvizuara, të tilla si çmimet, të cilat duhet të jenë të sakta dhe të destinuara.

Përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, i pranoj të gjitha kushtet e lartpërmendura dhe vërtetoj se të gjitha informatat e ofruara janë të sakta.

Në këtë mënyrë zotohem se do të ofrojmë shërbime në përputhje me:

1. Udhëzimet për ofertuesit,
2. Këtë formular për ofertim, së bashku me shtojcat ,

3. Konfirmimin tonë që vërteton se oferta jonë nuk ka qenë e dakorduar ose aranzhuar me ndonjë konkurrent potencial ose shoqatë tregtare dhe nuk do t'i kumtohet ndonjë pale të tretë,
4. Vërtetoj se biznesi ynë nuk ka ndonjë konflikt të interesit me stafin dhe bordin e autoritetit kontraktues.

VËRTETIMI MBI KONFLIKTIN E INTERESIT DHE BESUESHMËRINË

Sa i përket dorëzimit të kësaj kërkesë, nënshkruesi pajtohet dhe vërteton si në vijim:

Kam shqyrtuar me kujdes të gjithë punonjësit dhe anëtarët e bordit të listuar nga autoriteti kontraktues dhe bazuar në këtë shqyrtim, vërtetoj, sipas njohurive dhe besimin tim, me datën e paraqitur më poshtë, se nuk kam marrëdhënie aktuale ose potenciale që do të shfaqnin konflikt të interesit.

Emri dhe mbiemri:	
Kompania/Konsulenti:	
Data:	

Shtojca 5. DRAFT-KONTRATA

Bashkëngjitur: